



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2020-05  
**Vendosi:** Gjykatësi i procedurës paraprake  
Gjykatës Nikola Giju  
**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon  
**Data:** 12 qershor 2020  
**Gjuha:** Anglishte  
**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i redaktuar publik i  
Vendimit për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të të akuzuarit**  
Julius von Bone

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në përputhje me nenet 39(3) 53, 54 dhe 55 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 31, 32, 33, 37 39 dhe 208(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon vendimin e mëposhtëm.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 14 shkurt 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) parashtrori për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, së bashku me materialin mbështetës të pretendimeve faktike dhe një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e çdo prove me secilën akuzë.<sup>2</sup>

2. Më 28 shkurt 2020, gjykatësi i procedurës paraprake urdhëroi ZPS-në që deri më 18 mars 2020 të parashtronte, ndër të tjera, një aktakuzë të rishikuar.<sup>3</sup>

3. ZPS-ja parashtrori aktakuzën e rishikuar për konfirmim më 18 mars 2020.<sup>4</sup> Aktakuza e rishikuar për herë të dytë (“Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë”) u parashtrua për konfirmim më 20 mars 2020.<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-05, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesave në lidhje me të* (“Parashtrimi i Parë”), 14 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-05, F00003, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Urdhër Prokurorit të Specializuar në bazë të rregullës 86(4) të Rregullores*, 28 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-05, F00004, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për konfirmim dhe kërkesave në lidhje me të* (“Parashtrimi i Dytë”), 18 mars 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* me shtojcat 1 dhe 2 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-05, F00005, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për Herë të Dytë për konfirmim* (“Parashtrimi i Tretë”), 20 mars 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

4. Më 26 maj 2020, gjykatësi i procedurës paraprake lëshoi një urdhër, në të cilin caktohej data e synuar për nxjerrjen e vendimit mbi Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë.<sup>6</sup>

5. Më 12 qershor 2020, gjykatësi i procedurës paraprake konfirmoi Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë ("Vendimi i konfirmimit")<sup>7</sup> dhe lëshoi fletarrestim për Salih Mustafën ("z. Mustafa").<sup>8</sup>

## II. PARASHTRIME

6. Krahas konfirmimit të Aktakuzës së Rishikuar për Herë të Dytë, ZPS-ja kërkon, ndër të tjera, që gjykatësi i procedurës paraprake të miratojë kërkesën e saj për kontrollim dhe sekuestrim.<sup>9</sup> ZPS-ja kërkon që gjykatësi i procedurës paraprake të autorizojë ZPS-në dhe/ose autoritetet zbatuese të fletarrestimit në bashkëpunim me ZPS-në, që të (i) kontrollojnë z. Mustafa, vendarrestimin dhe vendbanimin e z. Mustafa; dhe (ii) sekuestrojnë çfarëdo prove që besohet se është përdorur në kryerjen e, është në lidhje me, ose mund të jetë provë e rëndësishme për veprat penale për të cilat ai akuzohet ("kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar").<sup>10</sup> Në veçanti, ZPS-ja kërkon [REDAKTUAR].<sup>11</sup> ZPS-ja vë në dukje se ndër sendet që do të sekuestrohen mund të përfshihen: [REDAKTUAR].<sup>12</sup>

---

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-05, F00006, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Urdhër për caktimin e datës së synuar për një vendim sipas nenit 39(2)*, 26 maj 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-05, F00008, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Vendim për konfirmimin e aktakuzës kundër Salih Mustafës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-05, F00009, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Vendim mbi kërkesën për lëshimin e fletarrestimit dhe urdhrit të transferimit*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>9</sup> ZPS-ja përfshin argumentimin e saj të Parashtrimit të Parë, me anë të referencave, pjesa B(4)-(6); shih Parashtrimin e Dytë, para. 7, 24(b). *Shih gjithashtu*, Parashtrimi i Tretë, para. 3.

<sup>10</sup> Parashtrimi i Parë, para. 13.

<sup>11</sup> Parashtrimi i Parë, para. 13.

<sup>12</sup> Parashtrimi i Parë, para. 13.

7. ZPS-ja parashtron se ekziston dyshim i bazuar se z. Mustafa ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, si edhe dyshim i bazuar se ai mund të ketë prova relevante me vete, në vendin e arrestimit ose në vendbanimin e tij.<sup>13</sup>

8. ZPS-ja më tej parashtron se, duke marrë parasysh rrezikun e ndërhyrjes dhe pengimit,<sup>14</sup> provat që mund të ketë z. Mustafa nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër dhe kontrollimi e sekuestrimi që kërkohen, mund të jenë e vetmja masë për sigurimin e provave për nevojat e hetimit.<sup>15</sup>

9. ZPS-ja parashtron se cenimi i shkaktuar mbi të drejtën për privatësi dhe pronë të z. Mustafa është proporcional me qëllimin legjitim të hetimit dhe nuk eliminon thelbin e këtyre të drejtave.<sup>16</sup>

10. Së fundi, ZPS-ja kërkon autorizimin e mbajtjes në ruajtje të çfarëdo prove të sekuestruar për aq kohë sa është e nevojshme për vlerësimin e provave, dhe në qoftë se provat gjykoen relevante, autorizimi të zgjatet për aq kohë sa është e nevojshme për hetimet dhe procesin gjyqësor.<sup>17</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Sipas rregullave 31 dhe 37 të Rregullores, kontrollimi i një personi, i pronës së tij ose i vendndodhjeve apo objekteve të tjera, si dhe sekuestrimi i çfarëdo prove të gjetur gjatë kontrollimit, mund të autorizohet në qoftë se:

- (a) ka pritshmëri të arsyeshme për privatësinë në lidhje me vendndodhjet që do të kontrollohen dhe sendet që do të sekuestrohen;<sup>18</sup>

---

<sup>13</sup> Parashtrimi i Parë, para. 14.

<sup>14</sup> Parashtrimi i Parë, para. 8-12.

<sup>15</sup> Parashtrimi i Parë, para. 14.

<sup>16</sup> Parashtrimi i Parë, para. 15.

<sup>17</sup> Parashtrimi i Parë, para. 16.

<sup>18</sup> Rregulla 37(2) e Rregullores. *Shih gjithashtu*, KSC-CC-PR-2017-03, F00006, Dhoma e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave*

- (b) lidhur me kontrollimin e vendndodhjeve dhe objekteve, ekziston dyshim i bazuar se (i) personi përkatës ka kryer, është duke kryer, ose është në prag të kryerjes së një vepre penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara;<sup>19</sup> dhe (ii) kontrollimi do të rezultojë, ndër të tjera, në zbulimin dhe sekuestrimin e provave të domosdoshme për hetimin. Lidhur me kontrollimin e personit, ekziston dyshim i bazuar se kontrollimi do të rezultojë në zbulimin e provave të një vepre penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe sekuestrimin e këtyre provave.<sup>20</sup>
- (c) kontrollimi është i domosdoshëm për hetimin;<sup>21</sup>
- (d) masa hetimore është e pashmangshme, d.m.th. në rrethanat konkrete provat nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër dhe kontrollimi dhe sekuestrimi që kërkohen, duket se janë e vetmja masë e efektshme për nevojat e hetimit;<sup>22</sup> dhe
- (e) cenimi i shkaktuar mbi të drejtën e personit për integritet personal, privatësi apo pronë, është proporcional me qëllimin legjitim të hetimit dhe nuk eliminon thelbin e të drejtës së garantuar.<sup>23</sup>

12. Sipas rregullës 37(4) të Rregullores, çdo vendim për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit përmban: (a) orarin, kohëzgjatjen dhe shkallën e kontrollimit dhe sekuestrimit, duke përfshirë të dhëna për personin ose pronën, vendndodhjen, mjediset ose objektin në lidhje me të cilat autorizohet masa dhe (b) procedurën e

---

*miratuar nga Plenarja më 29 maj 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Aktvendimi i Dhomës së Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara të Kosovës i datës 28 qershor 2017"), 28 qershor 2017, para. 69.*

<sup>19</sup> Rregulla 37(2)(a) e Rregullores

<sup>20</sup> Rregulla 37(3) e Rregullores.

<sup>21</sup> Rregulla 31(1)(b) e Rregullores.

<sup>22</sup> Rregulla 37(1) e Rregullores. *Shih gjithashtu, Aktvendimi i Dhomës së Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara të Kosovës i datës 28 qershor 2017, para. 62-67.*

<sup>23</sup> Rregulla 31(1)(c) e Rregullores.

raportimit në lidhje me zbatimin e masës së autorizuar dhe materialin e sekuestruar, në përputhje me rregullën 31(2) të Rregullores.

13. Bazuar në rregullën 39(1) dhe (2) të Rregullores, kontrollimi dhe sekuestrimi duhet të kryhen në prani të personit përkatës, përveçse kur ky person nuk mund të gjendet ose refuzon të jetë i pranishëm gjatë kryerjes së kontrollimit dhe kur çdo vonesë në kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit do të rrezikonte hetimin apo sigurinë ose pronën e një dëshmitari, viktime apo personi tjetër të rrezikuar. Prokurori i Specializuar gjithashtu duhet (a) t'i japë personit përkatës vendimin që autorizon kryerjen e kontrollit dhe sekuestrimit; (b) ta informojë personin në fjalë për të drejtat e tij; (c) të sigurojë praninë e mbrojtësit të personit, përveçse kur personi heq dorë nga ushtrimi i kësaj të drejte, apo logjikisht nuk mund të pritët prania e mbrojtësit; dhe (d) të sigurojë praninë e një vëzhguesi të pavarur gjatë kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit.

14. Bazuar në rregullën 32(1) të Rregullores, çdo material i sekuestruar mbahet, ruhet dhe mbrohet në mënyrën e duhur. Paneli që autorizon sekuestrimin duhet të përcaktojë (a) procedurën dhe masat për ruajtjen, mbrojtjen dhe transferimin e materialit të sekuestruar; (b) kohëzgjatjen e mbajtjes së materialit të sekuestruar; dhe (c) udhëzimet dhe afatet për kthimin ose asgjësimin e materialit të sekuestruar.

15. Neni 35(3) i Ligjit përcakton se policia në kuadër të ZPS-së ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që ka policia e Kosovës në bazë të legjislacionit të Kosovës. Në përputhje me nenin 53(1) të Ligjit, të gjitha subjektet dhe personat në Kosovë pa vonesë të papërligjur përmbushin çdo kërkesë për ndihmë, urdhër apo vendim të Dhomave të Specializuara. Bazuar në rregullën 202(2) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake mund të urdhërojë çfarëdo kushtesh që i gjykon të nevojshme, ndër të cilat edhe kushtet në lidhje me konfidencialitetin dhe masat mbrojtëse. Çdo urdhër i tillë përmbushet pa vonesë të papërligjur, në pajtim me nenin 53(1) të Ligjit dhe rregullën 202(3) të Rregullores.

16. Në përputhje me nenin 55 të Ligjit dhe rregullën 208(1) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake mund të kërkojë bashkëpunimin dhe ndihmën e një shteti të tretë nëse është e nevojshme për hetimin dhe ndjekjen penale të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

#### IV. DISKUTIM

##### A. KRITERET E KONTROLLIMIT DHE SEKUESTRIMIT

17. Kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar përfshijnë kontrollimin e z. Mustafa dhe të vendarrestimit dhe vendbanimit të tij. Duke qenë se kontrollimi i vendbanimit ose pronës së dikujt tradicionalisht ka të bëjë me privatësinë, gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se vendndodhje të tilla dhe sendet që mund të sekuestrohen gjatë kontrollimit të tyre, shkaktojnë pritshmëri të arsyeshme për privatësi. Po kështu, megjithëse vendarrestimi nuk dihet në këtë moment, ai mund të sjellë pritshmëri të arsyeshme për privatësi.<sup>24</sup> Për këto arsye është e zbatueshme mbrojtja e paraparë në Ligj dhe Rregullore.

18. Në kontekstin e kontrollimit të pronës, vendbanimit ose vendarrestimit të z. Mustafa dhe sekuestrimit përkatës të sendeve, gjykatësi i procedurës paraprake rikujton se, në Vendimin e Konfirmimit ai konstatoi se ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Mustafa ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.<sup>25</sup> Për më tepër, duke marrë parasysh sa më lart, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar lidhur me vendndodhjet dhe sendet e lartpërmendura mund të rezultojë në prova të domosdoshme për hetimin. Gjykatësi i procedurës paraprake gjithashtu konstaton se ekziston dyshim i bazuar se prova të tilla mund të gjenden në

---

<sup>24</sup> *Shih* Aktvendimi i Dhomës së Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara të Kosovës i datës 28 qershor 2017, para. 69

<sup>25</sup> Vendimi i Konfirmimit, para 123, 129, 133, 138, 141, 145, 151.

vendarrestimin ose vendbanimin e z. Mustafa. Në kuadër të kontrollimit të z. Mustafa, duke qenë se pretendohet se ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton ekzistencën e dyshimit të bazuar se kontrollimi mund të rezultojë në gjetjen dhe sekuestrimin e provave në lidhje me këto vepra penale. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar që përligj kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar.

19. Për më tepër, duke qenë se në vendbanimin apo vendarrestimin e z. Mustafa mund të gjendet informacion i rëndësishëm në lidhje me akuzat e konfirmuara, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar janë të domosdoshëm për hetimet e ZPS-së. Po ashtu, kontrollimi i z. Mustafa është i domosdoshëm për arsye se gjatë arrestimit apo kontrollimit të mjediseve të tij, ai mund të orvatet të fshehë në trup prova në lidhje me akuzat e konfirmuara. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar janë të domosdoshëm për nevojat e hetimit të veprave penale që pretendohet të jenë kryer nga z. Mustafa, si dhe për procese gjyqësore në të ardhmen.

20. Për sa i përket kriterit të pashmangshmërisë, gjykatësi i procedurës paraprake vë në dukje [REDAKTUAR] se [REDAKTUAR].<sup>26</sup> [REDAKTUAR] demonstronjë gatishmëri për pengimin e procesit, të shoqëruar me një rrezik të ndërhyrjes në prova. Rrjedhimisht, gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se çfarëdo prove që posedon z. Mustafa nuk mund të sigurohet në mënyrë tjetër dhe kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar gjatë arrestimit të tij mund të jenë e vetmja masë e efektshme për sigurimin e provave.

21. Së fundi, në lidhje me proporcionalitetin e cenimit të shkaktuar mbi të drejtat e z. Mustafa kundrejt qëllimit legjitim të hetimit, gjykatësi i procedurës paraprake mund

---

<sup>26</sup> Parashtrimi i Parë, para. 11; [REDAKTUAR].



të marrë parasysh, ndër të tjera, peshën e akuzave të konfirmuara,<sup>27</sup> kohëzgjatjen dhe shkallën e masave të kërkuara dhe garancitë mbrojtëse që do të zbatohen.<sup>28</sup> Qëllimi legjitim i hetimit është ndjekja penale e z. Mustafa në lidhje me veprat penale për të cilat akuzohet. Për sa u përket garancive mbrojtëse që do të zbatohen, gjykatësi i procedurës paraprake mban parasysh faktin se, sikurse mishërohet në rregullat 31-33 dhe 39 të Rregullores, ZPS-ja ka për detyrë të marrë masa përkatëse lidhur me të drejtën për integritet personal, privatësi apo pronë. Po aq i rëndësishëm është edhe zotimi i ZPS-së se do ta përshtatë kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar dhe/ose informojë dhe udhëzojë siç duhet cilindo autoritet tjetër që do të kryejë kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar, për të garantuar kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit në një mënyrë që përjashton informacion që nuk parashikohet të jetë i rëndësishëm.<sup>29</sup> Në përputhje me sa më lart, për aq sa kryerja e tyre u përmbahet kushteve të përcaktuara në Rregullore dhe në këtë vendim, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar janë proporcionalë me qëllimin legjitim të hetimit.

22. Pasi ka konstatuar se janë përmbushur kushtet e lartpërmendura, gjykatësi i procedurës paraprake autorizon kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar duke qenë se është në përputhje me kriteret e përcaktuara në rregullën 31 dhe rregullën 37 të Rregullores.

#### B. ORARI, KOHËZGJATJA DHE SHKALLA E KONTROLLIMIT DHE SEKUESTRIMIT

23. ZPS-ja nuk bën të ditur kohën e kryerjes së kontrollimit të z. Mustafa, të vendbanimit ose vendarrestimit të tij dhe sekuestrimit përkatës të sendeve. Sidoqoftë,

---

<sup>27</sup>Akuzat përfshijnë krimet e luftës të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme në shkelje të nenit 14(1)(c) të Ligjit.

<sup>28</sup> Aktvendimi i Dhomës së Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara të Kosovës i datës 28 qershor 2017, para. 64.

<sup>29</sup> Parashtrimi i Parë, para. 15.

është e qartë nga Parashtrimi i Parë se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar do të kryhen në kuadër të arrestimit të z. Mustafa. Duke baraspeshuar rëndësinë kohore të veprimeve hetimore dhe kohën që i nevojitet ZPS-së apo cilitdo autoriteti tjetër përkatës për organizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar nga njëra anë dhe pritshmërinë e arsyeshme për privatësi prej z. Mustafa si edhe nevojën për mbikëqyrje gjyqësore të zbatimit të këtyre masave, gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se për kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar mjaftojnë 14 ditë nga dita e arrestimit të z. Mustafa.

24. Kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar duhet të kufizohen në prova që besohet se janë përdorur në kryerjen e, janë në lidhje me, ose janë të rëndësishme për akuzat e konfirmuara. Në veçanti, gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar duhet të kufizohen në [REDAKTUAR]. Ndër sendet që do të sekuestrohen mund të përfshihen: [REDAKTUAR].

#### C. RAPORTIMI PËR KONTROLLIMIN DHE SEKUESTRIMIN

25. Në përputhje me rregullat 31(2) dhe 37(4)(b) të Rregullores, ZPS-ja duhet të raportojë për zbatimin e masave të kërkuara. Duke marrë parasysh kohën e nevojshme për përgatitjen e një raporti pas zbatimit të masës së kërkuar, ZPS-ja duhet të paraqesë një raport brenda 14 ditësh nga përfundimi i kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, ose brenda 14 ditësh nga përfundimi i afatit 14-ditësh të përcaktuar për kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, në cilëndo datë të mëhershme. Raporti duhet të përmbajë (i) datën, orën, kohëzgjatjen, vendndodhjen, shkallën dhe rrethanat e kontrollimit dhe sekuestrimit dhe (ii) përmbushjen e kriterëve të parapara në rregullën 39 të Rregullores.

#### D. MBAJTJA, RUAJTJA DHE MBROJTJA E MATERIALIT TË SEKUESTRUAR

26. Gjykatësi i procedurës paraprake e gjykon të nevojshme që ZPS-ja ta ruajë, mbrojë dhe transferojë materialin e sekuestruar në përputhje me procedurën standarde të kronologjisë së mbajtjes në ruajtje. Gjatë kësaj, ZPS-ja duhet të ndërmarrë masat e duhura për mbrojtjen e materialit të sekuestruar nga humbja, qasja e paqëllimshme ose e paautorizuar, ndryshimi, shpërndarja apo asgjësimi. Në raportin e vet, ZPS-ja informon gjykatësin e procedurës paraprake për procedurën dhe masat përkatëse për ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit të sekuestruar.

27. Gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se për vlerësimin e rëndësisë së materialit të sekuestruar mjafton një afat kohor prej katër muajsh, nga data e kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar. Në qoftë se konstatohet se materiali i sekuestruar është i rëndësishëm për hetimin apo për procese të ardhshme në lidhje me akuzat e konfirmuara, në pajtim me rregullën 33(1)(b) të Rregullores ZPS-ja mund ta mbajë materialin deri kur ai pushon së qeni i rëndësishëm në lidhje me qëllimin për të cilin është mbledhur. Në atë rast, materiali i sekuestruar duhet të kthehet ose asgjësohet në përputhje me rregullën 33(2)-(3) të Rregullores. Në qoftë se materiali i sekuestruar nuk lidhet me qëllimin e hetimit për të cilin është mbledhur dhe nuk është i rëndësishëm për hetimin e një veprë penale tjetër brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, materiali i sekuestruar duhet të kthehet ose asgjësohet menjëherë, në përputhje me rregullën 33(1)(a)(i) dhe (2)-(3) të Rregullores.

#### E. ZBATIMI DHE DORËZIMI I URDHËRIT TË KËRKUAR

28. Në qoftë se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar ose një pjesë e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar do të kryhen në Kosovë, gjykatësi i procedurës paraprake rikujton se sipas nenit 35(3) të Ligjit policia në kuadër të ZPS-së ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që ka policia e Kosovës në bazë të legjislacionit të Kosovës. Për këtë arsye, edhe ZPS-ja mund të konsiderohet "autoritet kompetent" sipas rregullës 49(1) të Rregullores, e aftë për dorëzimin dhe zbatimin e urdhrave të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat edhe të kontrollimit dhe

sekuestrimit të kërkuar. Rrjedhimisht, gjykatësi i procedurës paraprake autorizon ZPS-në që të dorëzojë dhe zbatojë këtë vendim. Nëse është e nevojshme, ZPS-ja mund ta dorëzojë dhe zbatojë vendimin në bashkëpunim me autoritetet kompetente në Kosovë.

29. Në qoftë se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar ose një pjesë e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar do të kryhen në një shtet të tretë, gjykatësi i procedurës paraprake, në përputhje me nenin 55 të Ligjit dhe rregullën 208(1) të Rregullores, kërkon nga autoritetet kompetente që këtë vendim ta dorëzojnë dhe zbatojnë në praninë e përfaqësuesve të ZPS-së.

## V. VENDIM

30. Për arsyet e lartpërmendura, në lidhje me **z. Salih Mustafa**, i lindur më 1 janar 1972, shtetas i Kosovës (numri personal [REDAKTUAR]), me vendbanim të njohur së fundi në [REDAKTUAR], *Prishtinë, Kosovë*, gjykatësi i procedurës paraprake:

- a. **AUTORIZON** kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar lidhur me kontrollimin e z. Mustafa, të vendarrestimit dhe vendbanimit të tij, si edhe sekuestrimin e çfarëdo prove që besohet se është përdorur në kryerjen e, është në lidhje me, ose mund të jetë e rëndësishme për hetimin ose procese në të ardhmen në lidhje me akuzat e konfirmuara, sikurse përcaktohet me hollësi në paragrafin 24 të këtij vendimi; dhe
- b. **AUTORIZON** ZPS-në që ta bëjë të ditur këtë vendim sipas rastit dhe nevojës, përfshirë autoriteteve që do të kryejnë kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar.

31. Në qoftë se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar ose një pjesë e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar do të kryhen në Kosovë, gjykatësi i procedurës paraprake **AUTORIZON** ZPS-në për dorëzimin dhe zbatimin e këtij vendimi sipas paragrafëve të lartpërmendur 23-24 dhe 28 dhe në përputhje me rregullën 39 të Rregullores.

32. Në qoftë se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar ose një pjesë e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar do të kryhen në një shtet të tretë, gjykatësi i procedurës paraprake:

- a. **URDHËRON** Administratoren që këtë vendim t'ua transmetojë autoriteteve kompetente për dorëzim dhe zbatim;
- b. **URDHËRON** ZPS-në të këshillohet me Administratoren lidhur me përgatitjet e nevojshme praktike për zbatimin dhe dorëzimin e këtij vendimi;
- c. **KËRKON** prej autoriteteve kompetente që të kryejnë kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar në praninë e një përfaqësuesi të ZPS-së dhe me kushtet e mëposhtme, për aq sa këto kushte nuk cenojnë legjislacionin në fuqi të shtetit të tretë:
  - i. kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar të përfundojnë brenda 14 ditësh nga dita e arrestimit të z. Mustafa;
  - ii. t'i lejohet z. Mustafa, mbrojtësit të tij dhe një vëzhguesi të pavarur që të jenë të pranishëm gjatë kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, përveç nëse vonesa e tyre rrezikon zbatimin e masës;
  - iii. t'i lejohet përfaqësuesit të pranishëm të ZPS-së që të shënojë orën, kohëzgjatjen, shkallën dhe hollësi të tjera lidhur me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të përgatisë listën e inventarit me përshkrim të hollësishëm dhe informacion për çdo send të sekuestruar; dhe
  - iv. materiali i sekuestruar, i cili mund të përfshijë [REDAKTUAR], t'i transferohet ZPS-së dhe të mbahet, ruhet dhe mbrohet prej ZPS-së.
- d. **KËRKON** prej autoriteteve kompetente që të informojnë përfaqësuesin e ZPS-së të pranishëm gjatë kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të

kërkuar për çfarëdo vështirësie ose pengese teknike apo logjistike në zbatimin e këtij vendimi;

- e. **KËRKON** prej autoriteteve kompetente që të trajtojnë kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar si konfidenciale, dhe ekzistencën dhe përmbajtjen e këtij vendimi t'ua bëjnë të ditur vetëm atyre subjekteve dhe personave përfshirja e të cilëve është absolutisht e domosdoshme për kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar.

33. Pavarësisht se ku do të kryhen kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar ose një pjesë e kontrollimit ose sekuestrimit të kërkuar, gjykatësi i procedurës paraprake:

- a. **URDHËRON** ZPS-në të raportojë për kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar brenda 14 ditësh nga data e përfundimit të tyre, ose brenda 14 ditësh nga përfundimi i afatit 14-ditësh të përcaktuar për kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit, në cilëndo datë të mëhershme, në përputhje me paragrafin 25 të këtij vendimi;
- b. **URDHËRON** ZPS-në të mbajë, ruajë dhe mbrojë materialin e sekuestruar dhe të raportojë në lidhje me procedurën dhe masat për ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit, në përputhje me paragrafin 26 të këtij vendimi; dhe
- c. **URDHËRON** ZPS-në të vlerësojë rëndësinë e materialit të sekuestruar brenda një afati kohor prej katër muajsh nga data e kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar dhe të mbajë në ruajtje, kthejë, ose asgjësojë materialin e sekuestruar, sikurse përcaktohet në rregullën 33 të Rregullores, në përputhje me paragrafin 27 të këtij vendimi.

/nënshkrim/

**Gjykatës Nikola Giju**  
**Gjykatës i procedurës paraprake**

E premte, 12 qershor 2020

Në Hagë, Holandë.